



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 938 Prot.

Tiranë, më datë 08.07.2021

VENDIM
Nr. 331, datë 07.07.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.07.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e pjesshëm të projektit “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit VODAFONE ALBANIA nëpërmjet shtimit të antenave për 3 stacione bazë të emërtuara: 1. 1294 XHAMIA E TABAKËVE; 2. 1344 HOTEL MONARC; 3. 1348 FARI, me aplikues Luan Dibra dhe zhvillues Vodafone Albania;
 - Shtyrjen e vendimmarrjes për stacionet 1294 XHAMIA E TABAKËVE dhe 1344 HOTEL MONARC. Të ripozicionohen antenat në objekte të tjera;
 - Miratimin e stacionit 1348 FARI.
 2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit VODAFONE ALBANIA nëpërmjet shtimit të antenave për 3 stacione baze të emërtuara: 1. 1294 XHAMIA E TABAKËVE; 2. 1344 HOTEL MONARC; 3. 1348 FARI, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

